



VENDIM

Nr. 151, Datë 11.12.2015

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË PROCEDURAVE TË BLERJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA OSHEE SH.A. TEK SHOQËRITË E
LICENSUARA PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 19; 69 gërma “ë” të Ligjit nr. 43/2015, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.12.2015, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorive Teknike të ERE-s, në lidhje me “Miratimin e rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike”,

Konstatohet se :

- Mbështetur në nenin 69 gërma “ë” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë elektrike” OSHEE sh.a. ka detyrimin të draftojë dhe dërgojë për miratim në ERE “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike”.
- Rregullorja është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. Nr 338, date 19.3.2008 dhe Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin nr. 68, Date 23.06.2008, i rishikuar.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e ”Rregullores së procedurave të blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria OSHEE sh.a. tek shoqëritë e licensuara për tregtimin e energjisë elektrike.”
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI